



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës” (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Gjetan Gjetani, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Robert Bitri, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Stavri Dhima – përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Kuqin – përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë deputetë!

Sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Relatore është zonja Tatjana Pirro. Data e shqyrtimit në seancë parlamentare është 19 korrik. Ne jemi komision përgjegjës, komisionet e tjera e kanë shqyrtuar.

Kemi të ftuar nga Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës zotin Stavri Dhima; nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi zotin Nikolla Lera, drejtorin, dhe Enkelejda Kuqin, përgjegjëse sektori, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision.

Pa humbur kohë, do ia jap fjalën zonjës Pirro.

Ilir Beqaj – A mund ta marr fjalën për procedurë?

Eduard Shalsi – Për procedurë fjalën e ka zoti Beqaj

Ilir Beqaj – Faleminderit, kryetar!

Ka 3-4 javë, nuk e di përse, qeveria ka zgjedhur komisionin tonë që projektligjet të përfaqësohen me nivel jo politik, e kam merakun më shumë kur jemi komision përgjegjës. Kështu ishte edhe te ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit”, kështu është edhe sot. Prandaj kërkoj që të shfrytëzoni autoritetin tuaj, të paktën në ato projektligje ku jemi komision përgjegjës, përfaqësuesi të jetë në nivel politik, sepse mes të tjerash projekti lidhet me programin e qeverisë, me zbatimin e tij, me angazhime programore dhe diskutimin e kemi edhe politik, pastaj për çështje teknike kemi kolegun që është relator dhe mund t’i zhvillojë në më shumë detaje.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Duke të falënderuar për sugjerimin, dua t’i bëj me dije komisionit që, kur njiheni me axhendën dhe rendin e ditës, mundeni të bëni propozime të tilla, pra t’i bëni që në momentin kur njiheni me shqyrtimin e projektligjeve dhe të datave. Nuk ka asnjë problem të marrim përfaqësues në nivel politik apo në nivel specialistësh, nga ana tjetër nuk ka një rregull se kush duhet ta përfaqësojë dhe në çfarë niveli mbrojtjen e projektligjeve në komisionet parlamentare. Por nëse gjykoni se është e nevojshme, mund t’u kërkojmë titullarëve në rastet e ardhshme dhe këtu nuk ka nevojë për debat. Në momentin që merrni kalendarin dhe projektligjet, bëni sugjerimet tuaja, deri më sot nuk ka asnjë lloj sugjerimi.

Ilir Beqaj – Nuk kërkoja sugjerim, kërkoja nga ju të shfrytëzoni autoritetin që qeveria të zbatojë Rregulloren e Kuvendit.

Eduard Shalsi – Që është?

Ilir Beqaj – Në komisionin përgjegjës projektligjin e prezanton propozuesi dhe rolin e propozuesit në institucion e ka ministri, i cili me Kushtetutë ka të drejtën ta propozojë, ta firmosë dhe pastaj vjen ta propozojë këtu. Kërkoj zbatimin e rregullit dhe jo sugjerim shtesë. Po të kem sugjerim shtesë, në momentin e caktuar do ta bëj.

Eduard Shalsi – Pra, ju kërkon që në të gjitha ligjet që depozitohen të jetë ministri, apo titullari, zëvendësministri?

Ilir Beqaj – Të zbatohet Rregullorja kur jemi komision përgjegjës, aty ku nuk jemi përgjegjës edhe mund të negociojmë. Unë jam deputet i këtij komisioni, por kam bërë për 3 vjet e gjysmë detyrën e ministrit dhe e di këtë aspekt të Rregullores.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Të them të drejtën, mua më duket i arsyeshëm qëndrimi i kolegut. Nuk është hera e parë që në komision, kur ka pasur prezantime të ligjeve të ndryshme, më shpesh opozita, por edhe ne kemi kërkuar që të ketë përfaqësim politik. Meqenëse ky projektligj nuk ka ngut për t'u futur në seancën që vjen, jam i mendimit ta shtyjmë mbledhjen dhe të kërkojmë një përfaqësues politik.

Eduard Shalsi – Hera e fundit që kemi kërkuar me detyrim një ministër ka qenë muaji maj, ku mbledhja dështoi për shkak të kuorumit. Nga tani e tutje, në varësi të rëndësisë që kanë projektligjet do t'i kërkojmë edhe përfaqësuesit politik. Në praktikën dhe në rregullin e këtij komisioni nuk ka rëndësi se cili është propozuesi, për shembull, zonja Eglantina që ka qenë ministre, nuk ka ardhur në të gjitha ligjet që janë paraqitur në komision. Nuk e di se çfarë keni bërë ju kur keni qenë ministër te Komisioni i Shëndetësisë dhe te komisionet e tjera. Ka ligje ku prezenca e titullarit dhe ministrit është vetë e domosdoshme, por jo domosdoshmërisht, të qenurit komision përgjegjës e përcakton se cili duhet ta mbrojë ligjin në komision.

Vijojmë me axhendën, a ka ndonjë gjë tjetër për procedurë?

Ilir Beqaj – Mund ta marr fjalën për procedurë?

Eduard Shalsi – Po.

Ilir Beqaj – Edhe zëvendësministri është funksion politik.

Eduard Shalsi – Dakord. Fjalën e ka zonja Pirro.

Tatjana Pirro – Megjithëse i dëgjova të gjitha, unë jam brenda profesionit, sepse jam ekonomiste.

Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese Tregtisë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj me cilësinë e komisionit përgjegjës në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, e cila është e ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 116/2013. Ndryshimet e propozuara synojnë të përfshijnë në marrëveshjen me qeverinë pritëse, disa dispozita që rregullojnë trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit TAP, kryesisht për të përfshirë zbatimin e skemës së auto-faturimit në lidhje me TVSH-në e investitorit të projektit të kontraktit, për sa i përket furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Ky propozim i ri i skemës së TVSH-së në lidhje me projektin TAP është kombinim i sistemit të auto-faturimit me sistemin tradicional të aplikimit të TVSH-së, që synon të ulë parametrat e menaxhueshëm në shumën e kërkesave për rimbursimin e TVSH-së, me qëllim që projekti TAP të mos vihet në vështirësi financiare gjatë punimeve.

Rishikimi i skemës së TVSH-së dhe kalimi në skemën e re të propozuar vlerësohet se është i nevojshëm, duke marrë në konsideratë jo vetëm rimbursimin e përshpejtuar të TVSH-së për kërkesat e paraqitura tashmë nga projekti TAP, por edhe fluksin e rritjeve që pritet të vijë gjatë viteve 2018-2019.

Sipas skemës së re të propozuar, sistemi i auto-faturimit nënkupton se detyrimi për llogaritejen dhe pagesën e çdo detyrimi TVSH-je të autoriteteve tatimore, për të gjitha furnizimet e nevojshme të lidhura me projektin TAP gjatë fazës së ndërtimit, do të bjerë mbi përfituesin e furnizimit dhe jo mbi furnizuesin e mallit. Ky kalim i përgjegjësisë për të llogaritur dhe paguar TVSH-në nga furnizuesi te përfituesi i furnizimit, quhet mekanizmi i auto-faturimit. Kjo skemë specifike do të aplikohet për kontraktorët e nivelit të parë dhe të dytë, për të cilët do t'i komunikohet drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ndërsa nga niveli i tretë i kontraktorëve dhe në vazhdim parashikohet aplikimi i sistemit tradicional të TVSH-së. Importet e kryera nga investitorët e projektit ose nga çdo kontraktor i nivelit të parë, gjatë fazës së ndërtimit për furnizimet e mallrave, që lidhen me projektin, janë të përjashtuara nga TVSH-ja, ato trajtohen si furnizime mallrash të kryera nga importuesi për veten tij, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike.

Për sa u përket furnizimeve të mallrave e shërbimeve brenda vendit nga një kontraktor i nivelit të parë, ose i nivelit të dytë, vetëm përfituesi i mallrave dhe i shërbimeve do të jetë i

detyruar të paguajë TVSH-në dhe ka të drejtën e zbritjes së kësaj TVSH-je sipas rregullave të përcaktuara.

Aplikimi i mekanizmit të auto-faturimit parashikohet nga direktivat e BE-së nr. 2006/112 EC “Për sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar” në nenet 194,199 të saj, si përjashtim ndaj rregullit kryesor që TVSH-ja është e pagueshme nga personi që kryen furnizimin. Gjithashtu, ky mekanizëm është i njohur nga autoritetet shqiptare, pasi është përdorur në kuadër të legjislacionit fiskal.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime financiare në buxhetin e shtetit.

Në aspektin formal ligji përbëhet nga dy nene, të cilat parashikojnë ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës dhe hyrjen në fuqi.

Në aspektin ligjor, ky projektligj i paraqet Kuvendit për ratifikim në zbatim të ligjit nr. 7883 dhe nenit 121, pika 1, të Kushtetutës. Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe në aspektin procedural ka respektuar të gjitha kërkesat sipas Rregullores së Kuvendit.

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji, ftoj të gjithë anëtarët e këtij komisioni ta votojnë.

Gjithashtu, kam edhe disa pyetje për teknikientët që janë në panel.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Për pyetjet do ta jap fjalën pak më vonë. Megjithëse, shpjegimi juaj ishte pothuajse ezaurues, gjithsesi, përfaqësuesi i ministrisë mund të na thotë pse lindi si e nevojshme kjo marrëveshje. A ka marrëveshje të ngjashme? A do të jetë një praktikë edhe për rastet të tjera? Pastaj do të kalojmë te pyetjet e zonjës relatore.

Nikolla Lera – Faleminderit!

Zonja relatore e shpjegoi në detaje ndryshimin e skemës. Ky projektligj që kemi sjellë ka për qëllim ndryshimin e skemës së llogaritjes dhe të pagesës së TVSH-së. Deri tani skema e aplikuar ka qenë skema klasike, ku çdo operator faturonte TVSH-në dhe TAP-i, i cili mbledhte TVSH-në nga kontraktorët dhe nënkontraktorët e tij, dhe nga nënkontraktorët e nënkontraktorëve, paraqiste kërkesat për rimbursim pranë administratës fiskale. Në tërësi projekti i TAP-it ka një TVSH të rimbursueshme prej 33 miliardë lekësh, gjatë gjithë kohës që do të vazhdojë ndërtimi deri në operim. Pra, është një barrë shumë e madhe për t'u

rimbursuar, rreth 33 miliardë lekë, ndërkohë që mesatarja e rimbursimeve vjetore të dhëna nga administrata tatimore në këta 5-6 vjetët e fundit, lëkundet diku te 10 miliardë lekë për të gjithë tatimorët e Shqipërisë, pra për 20 mijë tatimpagues.

Nga fillimi i projektit e deri tani ka vazhduar kjo skemë dhe TAP-i është rimbursuar për kërkesat e tij për rimbursim që ka paraqitur. Ndërkohë, kemi rënë dakord me TAP-in që të këtë një shtyrje prej 6 muajsh të rimbursimit krahasuar me afatin ligjor, 180 ditë më vonë se afati i parashikuar në ligj. Ligji thotë: “Nëse një tatimpagues plotëson kushtet për rimbursim brenda një muaji nga miratimi i kërkesës, duhet të rimbursohet për TVSH-në e kërkuar”.

Ndërkohë ne kemi një marrëveshje me TAP-in për ta zgjatur këtë afat në 180 ditë. Gjithsesi, volumi i madh i punëve dhe faturimet e mëdha që bëhen e kanë rritur volumin dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në këtë situatë, kemi dy objektiva për të realizuar: në radhë të parë, për të mos krijuar një situatë ku administrata fiskale nuk do të jetë në gjendje të përballojë kërkesat e mëdha për rimbursim, si dhe për të mos i krijuar kompanisë TAP probleme të mëdha në *cash flow*-n e vet, domethënë penges në projekt për arsye të mosmarrjes së rimbursimeve, ne e pamë të arsyeshme që të ndryshojmë skemën: nga një skemë klasike rimbursimi ta kthejmë në një skemë me *revers charge*, pra autofaturim, e cila është e parashikuar nga direktiva 6 e VAT-it dhe njihet në Shqipëri se është aplikuar për projektin “Devoll *Hydropower*”. Pra ka disa vite që kjo skemë funksionon në mënyrën më të mirë të mundshme. Nisur nga këta faktorë, ne bëmë këtë propozim, sepse...

Eduard Shalsi - Ka dy objektiva, ky është i pari, po i dyti?

Nikolla Lera – Objektivi i parë është që administrata fiskale, financat publike shqiptare të mos ndodhen para faktit që kanë për të rimbursuar një shumë, e cila mund të krijojë probleme me buxhetin e vitit 2018 apo 2019, kurse e dyta është që, në kushtet kur administrata fiskale mund të mos jetë në gjendje të zbatojë afatet ligjore të rimbursimit, atëherë kjo krijon probleme edhe për kompaninë TAP, sepse këto fonde ka parashikuar t’i marrë në kohën e duhur për të siguruar ecurinë e projektit.

Thashë që përvoja e Devollit është shumë e mirë, pasi nuk ka krijuar asnjë problem e ka lehtësuar buxhetin e shtetit nga barra e rimbursimeve dhe as kompanisë nuk i ka krijuar probleme në *cash flow*-in e vet. Nga ky ndryshim parashikojmë që, duke marrë në konsideratë që ligji mund të hyjë në fuqi në muajin gusht ose shtator, të dalin jashtë skemës rreth 10 miliardë lekë të parashikuara për periudhën 10 gusht 2018 - janar 2020, kur përfundon dhe projekti. Pra, ne i lehtësojmë financat publike me këtë barrë prej 10 miliardë

lekësh dhe, njëkohësisht, me stokun e kërkesave që kemi për t'ia rimbursuar TAP-it, apo me kërkesat që do të vijnë për periudhën janar-qershor 2018 do të kemi mundësi për të përshpejtuar dhënien e tyre në mënyrë që të mos i krijojmë probleme kësaj kompanie nga pikëpamja e *cash*-it.

Eduard Shalsi – A ka pyetje relatorja?

Nikolla Lera – Më falni, zoti kryetar, kam edhe diçka tjetër. Nëse do të vazhdonim me këtë skemë dhe nuk do të ishim në gjendje të respektonim afatet ligjore të rimbursimit, atëherë do të ishim të detyruar të paguanim interesa dhe kamatëvonesa. Në këtë mënyrë ne eliminojmë një aspekt tjetër që do të ishte barrë për buxhetin e shtetit.

Tatjana Pirro – A ka eksperiencë administrata tatimore në administrimin e këtij sistemi? Kam nja dy a tre pyetje, t'i bëj të gjitha?

Eduard Shalsi – Po, bëji të gjitha.

Tatjana Pirro – Për Devollin është përdorur për raste të tjera.

Në lidhje me administratën tatimore, sa mendoni se do të reflektojë lehtësitë administrative të pretenduara ky ndryshim i skemës? A janë evidentuar nga TAP-i kontaktorët e nivelit të parë dhe të dytë? A mendoni se do të ketë efekt në buxhetin e shtetit në fillim të aplikimit të skemës së re?

Eduard Shalsi – Do t'i mbani shënim, sepse do të ketë edhe pyetje të tjera.

Faleminderit, Tatjana!

Fjalën e ka Vullneti.

Vullnet Sinaj - Unë doja të na shpjegonte më mirë pse duhet t'ia rimbursojë TVSH-në TAP-i kur TAP-i i blen këto produkte për t'i investuar për vetën e vet këtu në Shqipëri. Nuk e kuptoj pse duhet të rimbursohet!?

Eduard Shalsi – A ka koleg tjetër që do të pyes?

Po, zoti Suli.

Rakip Suli – E gjithë vlera për rimbursim ka qenë rreth 33 miliardë lekë, në mos gaboj, se TVSH-ja rimbursohet. Deri në këtë periudhë është shlyer i gjithë detyrimi, flas për rimbursimin e kësaj TVSH-je nga shteti. Nëse ka diferencë të parimbursuar jemi të detyruar ta bëjmë këtë ndryshim, se, nëse nuk rimbursohet në kohë, ka edhe interesa. Nëse nuk është shlyer, a ka pasur interesa për diferencën që nuk i është rimbursuar kompanisë në kohë?

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zonja Gjermani, pastaj e kanë radhën zoti Baraj dhe zoti Beqaj.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke falënderuar ekipin që prezantoi projektligjin, doja të dija shkurtimisht se cili do të jetë impakti i këtij projektligj pasi të hyjë në fuqi? Me pak fjalë, çfarë do të ndodhë realisht? Si do të ndikojë ky pozitivisht? Ju lutem, na shpjegoni!

Nëse mundem, zoti kryetar, do të doja që, përveç pyetje, të thosha diçka për procedurë, meqenëse u diskutua këtu. I mbështes kolegët Beqaj dhe Baraj për sa i përket përfaqësimin politik në prezantimin e projektligjeve dhe mendoj se kjo është normë, përveç se është në Rregullore. Por, meqë jemi në diskutim, le ta vazhdojmë mbledhjen, por herën tjetër kërkojmë nivel ministri apo zëvendësministri. Meqenëse mu referuat mua, mund të them me përgjegjësi se, kur kam qenë ministre, kam ardhur vetë për të prezantuar ligjet, kurse për marrëveshjet mund të kenë qenë dy zëvendësministrat, kolegët e mi. Vetëm në rastet kur është diskutuar nen për nen, mund të kenë marrë pjesë drejtorë institucionesh apo drejtorë drejtorish. Këtë e them me përgjegjësi të plotë

Faleminderit!

Ilir Beqaj - A ka ndonjë vlerësim të taksave që janë krijuar dhe janë paguar si pasojë e aktivitetit të TAP-it në Shqipëri? Domethënë, janë punësuar qindra vetë, të cilët kanë paguar tatim të ardhurash personale dhe për ta janë paguar sigurimet shoqërore e shëndetësore. Nënkontraktorët vendas të TAP-it, se këta të huajt nuk interesohen, kanë gjeneruar të ardhura dhe fitime në Shqipëri. Tatimi i tyre a është ditur si të vlerësohet? Nëse ju thoni që TAP-i ka rreth 33 miliardë TVSH të kreditueshme kjo do të thotë se në x vjet aktiviteti i tij ka xhiruar 200 miliard lekë. Pra, që nga vitit 2013, kur ka filluar, e deri kur të mbarojë, do të shkojë në rreth 33 miliardë. Kjo do të thotë se ka nga mbrapa 200 miliardë lekë bashkë me TVSH-në, ose rreth 166 miliardë lekë aktivitet ekonomik, që e ka me nënkontraktorët.

A keni ndonjë vlerësim të përafërt se sa mund të kenë qenë të ardhurat e hyra ndër vite si pasojë e këtij aktiviteti të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë, nga nënkontraktori i nivelit të dytë apo të tretë?

Autofaturimi, që është përdorur në përputhje me direktivën në rastin e Devollit, a ka nevojë të pasqyrohet dhe të ndiqet në ligjet kuadër fiskale, apo do ta zgjidhni vetëm në raste marrëveshjesh, si puna e tyre? Me sa unë di, kur dikush importon sot *software*, e zgjidh direkt me autofaturim, nuk e zgjidh dot ndryshe. Unë di që nuk është vetëm “Devolli”, i cili është vetëm një nga rastet e mëdha.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

A ka njeri tjetër që do të bëjë pyetje? Nuk ka.

Fjala është për ju zoti Lera.

Do t'i referoheni deputetit që ka bërë pyetjet, pastaj do t'i përgjigjeni.

Nikolla Lera – Zonja relatore bëri katër pyetjet e para.

Pyetja e parë ishte: a ka eksperiencë administrata tatimore për të menaxhuar skema të tilla? Sikurse e theksuam, ne kemi një përvojë të mirë me investimin e Devollit, mbase jo të këtyre përmasave, por të përafërt. Kjo do të thotë se administrata tatimore ka një përvojë shumë të mirë kontrolli dhe verifikimi të skemave të tilla. Është më e thjeshtë. Pse?

Si ka funksionuar deri tani projekti TAP me skemën normale? Në krye kemi TAP-in, i cili ka 5-6 nënkontraktorë kryesorë, të cilët kanë nga 5, 6, 10, 20 nënkontraktorë të tyre. Këta nënkontraktorë të kontraktorëve kanë një numër të konsiderueshëm nënkontraktorësh. Kështu që pema e funksionimit e TAP-it dhe e TVSH-së shkon nga TAP-i, që është një subjekt, në dhjetëra e qindra subjekte të tjera. Në kushtet e skemës normale të TVSH-së për të gjithë TVSH-në që kërkon TAP-i (që është produkt i faturimeve nga poshtë lart të të gjitha subjekteve) ne, si shtet, duhet të garantojmë që 33,4 miliardë lekëT, me të cilat do të rimbursojmë TAP-in, të shohim se kush na i ka paguar, sepse TAP-i krediton atë që tjetri e ka të pagueshme. Pra, sa do të na paguajnë kontraktorët e brezit të parë? 4 apo 5? Sa do të paguajnë nënkontraktorët e brezit të dytë? 80? Sa do të paguajnë nënkontraktorët e nënkontraktorëve të brezit të tretë apo të katërt? 800?

Pra, është një sistem që kërkon një menaxhim kontrolli dhe verifikimi të jashtëzakonshëm, që, e thënë hapur, nuk është e thjeshtë dhe e lehtë për t'u realizuar, sepse duhet të kontrollohet çdo qelizë për t'u siguruar që ky rimbursim i dhënë është paguar nga ky grup prej qindra subjektesh.

Kalimi në skemën e re nëpërmjet skemës së përjashtimit apo të *revers charge*-it është më i thjeshtë, sepse ne e kemi të sigurt dhe kontrollojmë vetëm pjesën e kontraktorëve të brezit të parë, të dytë dhe disa të brezit të tretë. Pra, thjeshtohet dhe këtë e kemi të provuar me skemën e Devollit.

Pyetja e dytë ishte: sa mendoni se do të reflektohet vështirësi në këtë proces? Unë besoj se qëllimi që ne propozuam këtë ndryshim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do të lehtësojë buxhetin e shtetit nga kërkesa për rimbursim. Edhe tani ne e kemi të rënduar situatën me kërkesat për rimbursim, pavarësisht se kemi pasur mirëkuptimin e tyre dhe kemi operuar me atë shtyrjen me 180 ditë të kërkesave, por në kushte normale nuk e kemi zbatuar skedulin e pagesave të kërkesave të deritanishme për rimbursim, që do të thotë se ne lehtësohemi nga kjo barrë, por njëkohësisht edhe subjekti, edhe TAP-i, do të lehtësohet

nga mungesa e *cash*-it. Pse? Sepse nuk do të jetë i detyruar të paguajë nënkontraktorët e vet me punime +20% TVSH, por do t'i paguajë me -20%. Pra, do të ketë përfitime nga pikëpamja e *cash*-it.

E treta, “A janë evidentuar kontraktorë?” Patjetër. Paralelisht me hartimin e këtij ndryshimi ne kemi identifikuar në bashkëpunim me kompaninë dhe kemi saktësuar në mënyrë eksplicite, pra me listë fundore, kontraktorët e brezit të parë dhe kontraktorët e brezit të dytë, sepse listat do të jenë definitive, me emër dhe ai ka të drejtë të ndryshojë vetëm ndonjë kontraktor nga lista ekzistuese vetëm me miratimin e administratës tatimore, por për këtë qëllim do të dalë një udhëzim në zbatim të këtij ligj, sikurse është vepruar edhe në rastin e Devollit.

Edhe në rastin e Devollit ka një listë të kontraktorëve të parë dhe të nënkontraktorëve, të cilët kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe askush nuk lejon të hyjnë kontraktorë apo nënkontraktorë pa dijeninë ose pa miratimin e administratës fiskale.

“A do të ketë efekte në buxhet?” Efektet në buxhet do të jenë në dy kuptime.

Së pari, do të kemi, sikurse e thashë, një lehtësim të barrës për të rimbursuar, se, në fund të fundit, edhe rimbursimi është shpenzim i buxhetit, do të kemi një lehtësim të ndjeshëm, por ajo që do të ndodhë do të jetë një ulje e pagesave, sepse sikurse e shpjeguam, atë që ky e kërkon të rimbursueshme në krye, të tjetër e kanë të pagueshme.

Përvoja e këtij një viti e gjysmë me TAP-in apo përvoja me Devollin, na ka treguar se shuma e kërkuar në maj për rimbursim është 3 herë me madhe krahasuar me pagesat që bëjnë qindra e mijëra subjekte të tjera. Pra, që të arrihet idealja, duhet që gjithë këtë shumë që jep për rimbursim, të jesh në gjendje ta kontrollosh në kohë reale çdo muaj, te qindra e qindra të tjerë.

Pra, do të ulen pagesat për shkak të skemës me deklarin, por përfitimet nga ulja e kërkesave për rimbursim do të jenë shumëfishi i uljes së pagesave.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Nikolla Lera – Faleminderit ju!

Eglantina Gjermani – Më fal, Shalsi!

Po sjell një shqetësim të banorëve të qytetit tim, të Lushnjës, ku kalon dhe TAP-i. Nuk e di nëse kam të drejtë dhe kujt do t'i drejtohem, por po e them si shqetësim: prishja e rrugëve nga kamionët dhe nga skrepet që kalojnë dhe ngelen të parregulluara.

Faleminderit nëse këtë shqetësim e përcillni te njerëzit e duhur!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ndize pak mikrofonin.

Stavri Dhima – Përpara se të kaloj te përgjigja e pyetjes së deputetes Gjermani, në lidhje me atë që adresoi zonja deputete, në detyrimet kontraktuale që ka kompania TAP, përveç ndërtimit të rrugëve, aty ku ka parashikuar të ndërtojë, si dhe mirëmbajtjes së rrugëve që ai ndërton, ka detyrimin ligjor të mirëmbajë të gjithë infrastrukturën që përdoret dhe dëmtohet prej tij. Për këtë arsye është parashikuar një fond prej rreth 14 milionë euro, që do të jetë në dispozicion të mbështetjes për një pjesë të rrugëve, të cilat duhet të bëhen dhe do të quhen si kontribut lokal, por specifikisht, për rastet në Lushnjë, në zonën e Vithkuqit, në zonën e Semanit në Fier, për rastet e një pjesë të rrugëve (sepse janë kryesisht në zonën e Berat-Çorovodë dhe janë rrugë të reja), aty ku janë prishur rrugët ekzistuese të komunitetit, do të ribëhen totalisht dhe tërësisht nga kompania TAP, jashtë këtij detyrim prej 14 milionë eurosh që ai ka, për të bërë rrugë apo për t'i dhënë kontribut komunitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rastin konkret... janë marrë 2 lloj masash...

Ky që po bën zoti Beqaj ka qenë një diskutim shumë i drejtë.

Këta qytetarë, po i quajmë, të Vithkuqit apo të zonës së Lushnjës, shkojnë përditë në shkollë, në punë. Ata nuk do të presin sa të mbarojë TAP-i. Kështu që është lënë detyrë. TAP-i në këto zona, në dijeninë time (dhe besoj se kam informacion), ka bërë mirëmbajtje provizore të rrugëve, në mënyrë që ato të jenë të aksesueshme normalisht gjatë kohës që TAP-i punon ende, ndërkohë që në përfundim të punimeve të TAP-it, gjithë rruga, për shembull, e Vithkuqit po e përmend shpesh meqë është pak më e dukshme), nga ndarja në Floq, rruga Korçë-Ersekë e deri në Vithkuq do të ribëhet e tëra, do të rikonstruktohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të ribëhet me standardin normal të punës.

Mund të vazhdoj me...?

(Diskutime pa mikrofon)

Në lidhje me atë që pyet zonja Gjermani, se cili do të jetë impakti kur projekti të hyjë në operim, përveç sa është trajtuar në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës, ku janë detyrimet tatimore, janë të gjitha detyrimet e tjera fiskale, përfshirë edhe blerjet e pagesave të TVSH-së, që do të bëhet...

Eduard Shalsi – Qartë, qartë.

Stavri Dhima - ...nga përfituesit. Përfitimet do të mund t'i ndajmë në tri grupe, që do të jenë impakti që do të ketë TAP-i për krijimin rrjetit të gazifikimit në Shqipëri.

Pavarësisht se TAP-i vetë nuk është furnizues gazi, do të krijojë të gjitha lehtësirat e nevojshme, do të krijojë edhe infrastrukturën e nevojshme që nga tubacioni i TAP-it në

Shqipëri të ketë një pikë daljeje, pra një nënstacion të madh, nëse mund ta quajmë kështu, ku do të dalë gasi që transportohet te TAP-i për të rregulluar presionin dhe të gjitha me radhë.

Pjesa e dytë. Do të krijohen të ardhurat direkte, siç është parashikuar edhe me marrëveshje nga TAP-i, që janë të ardhura që do t'i krijojë kompania që operon në Shqipëri, që do të ketë selinë dhe të gjitha aktivitetet e saj, por njëkohësisht edhe të ardhurat që krijohen si detyrime, si: taksa, tatime, përfitime e të tjera me radhë, të cilat janë parashikuar. Meqenëse në këtë rast janë edhe 3 vende të tjera dhe selia qendrore e TAP-it do të jetë në Zvicër, janë nënshkruar marrëveshje për përjashtimin nga tatimet...

Pjesa e tretë. Do të krijohen fronte pune, jo thjesht në atë kuptimin e "aq njerëz sa mund të duhen për të operuar". Kuptohet, kundrejt plotësimit të kushteve dhe kërkesave që do të jetë ai standard pune që kërkon TAP-i.

Në një diskutim të mëparshëm, shërbime të tëra që do t'i kryhen kompanisë TAP gjatë periudhës së operimit, është kërkuar dhe është raportuar që do të kryhen nga subjekte shqiptare, siç është rasti konkret i kompanisë Albgaz, e cila do të marrë përsipër shërbimin e mirëmbajtjes dhe të operimit të TAP-it në territorin shqiptar.

Duke qenë se aktualisht kompania Albgaz (ju duhet të jeni në dijeni) nuk ka atë standard dhe ekspertizën e nevojshme të personelit të saj, fillimisht do të operojë me një marrëveshje bashkëpunimi me një kompani të huaj, që, realisht, pas një procesi përzgjedhjeje është përzgjedhur kompania italiane SNAM. Ndërkohë, pas kësaj periudhe do të vazhdojë e vetme të realizojë gjithë këtë, që është njëkohësisht një pjesë e të ardhurave.

E fundit, ndoshta edhe më e rëndësishmja, ky projekt e shndërron Shqipërinë në një nyje të rrjeteve të gazit, pasi është parashikuar të realizohet edhe projekti i gazsjellësit Adriatiko-Jonian, që do të lidhë Shqipërinë me Kroacinë, i cili është në fazën e përgatitjes së projektit paraprak teknik. Është parashikuar të ndërtohet projekti i gazsjellësit Shqipëri-Kosovë dhe më tej drejt Serbisë, i cili është një projekt në fazën e studimit parafizibilitetit.

Në këtë mënyrë, Shqipëria, përveç lidhjes me Greqinë dhe një lidhjeje të mundshme me Maqedoninë, shndërrohet *de facto* edhe në një nyje të rëndësishme të rrjeteve të gazit në Europën Juglindore.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve të tjera.

Nikolla Lera – Vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Deputeti ka pyetur se përse duhet ta rimbursojmë TAP-in për TVSH-në. TAP-i është një kompani e të drejtës shqiptare, si çdo kompani...

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Nuk ishte pyetja jote.

Nuk e keni mendjen.

Nikolla Lera – S’kemi arritur akoma te pyetjet tuaja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

TAP-i është një kompani si çdo kompani tjetër e regjistruar në Shqipëri dhe, natyrisht, zbaton legjislacionin shqiptar, që do të thotë se bën blerje dhe realizon shitje. Aktualisht nuk ka shitje, sepse është në fazë investimi. Natyrisht që ka blerje. Çfarë blen? Blen tubat apo materialet e tjera nga importi, blen dhe situacionet e punimeve nga nënkontraktorët e vet, të cilët natyrisht që i faturojnë TVSH.

Ligji shqiptar thotë se nëse ti paguan TVSH dhe je me tepricë kreditore, e cila është më tepër se 400 mijë lekë dhe bartet për më tepër se 3 periudha tatimore, ke të drejtën ligjore për t’u rimbursuar. Natyrisht që ai kërkon rimbursimin, sepse e ka në shifra gjigande, jo në këto parametra minimale që parashikon ligji.

Vullnet Sinaj – Këtu nuk kemi të bëjmë me një ndërmarrje që blen dhe shet, që krijon tepricë kreditore në TVSH dhe do ta shesë tepricën kreditore. Këtu kemi një ndërmarrje që investon, që TVSH-në që ka blerë, e kthen në kapital, e ka investuar në tuba dhe në kapital. Atëherë, pse duhet t’ia rimbursojmë? Unë nuk jam akoma i bindur se pse duhet t’ia rimbursojmë.

Në qoftë se marrim ligjin shqiptar dhe një ndërmarrje shqiptare që vepron në të njëjtën mënyrë, kur një ndërmarrje shqiptare ndërton për veten e vet, e paguan TVSH-në edhe kur e kalon produktin e blerë, importuar për ndërtimin e ndërmarrjes së vet. I vendos edhe një fitim rreth 7% dhe paguan prapë edhe një TVSH për atë investim që bën. Në këtë rast, pse po rimbursojmë gjithë këtë TVSH? Mund të ishin të ardhura për shtetin këto.

Faleminderit!

Nikolla Lera – Në marrëveshjen e ratifikuar nga Kuvendi, pika 24/10 thotë: “Shteti pranon se TVSH-ja nuk duhet të jetë kosto për projektin, si direkt, ashtu edhe nëpërmjet mekanizmit të vetëfaturimit. Duke qenë se qëllimi i projektit nuk është ofrimi i mallrave, punëve apo shërbimeve për konsum përfundimtar brenda shtetit, por ofrimi i shërbimeve për transportuesit, që veprojnë si persona të tatueshëm jashtë territorit shqiptar, i cili është në të njëjtën linjë me parimin e paanshmërisë së sistemeve të TVSH-së për të pajisur bizneset me aktivet të tatueshëm, me një të drejtë të përgjithshme për rimbursimin e TVSH-së.”

Pra, jo vetëm që është parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi, e cila prevalon ndaj ligjit vendas, por edhe në kuptim logjik, ai po bën një investim.

Natyrisht, për këtë investim, të cilin do ta përdorë më vonë, ka paguar TVSH. Çfarë do të bëjë nesër ai? Ai nesër do të faturojë shërbimet që u kryhen të tretëve, shërbimin e dhënies me qira. Faturat që ai do të bëjë, meqenëse klientët e tij janë jashtë Shqipërisë, janë jashtë objektit të TVSH-së. Ligji shqiptar thotë se nëse një furnizim është jashtë objektit të TVSH-së, ti ke të drejtë të kreditosh dhe të rimbursosh TVSH-në e paguar në blerje.

Pra, nga dy këndvështrime, nga këndvështrimin i interpretimit të ligjit vendas dhe nga këndvështrimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar në Kuvend, situata është e qartë, ai duhet të rimbursohet.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Qartë.

Vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve të tjera.

Nikolla Lera – Për pyetjen e zotit Suli, se sa është rimbursuar deri tani dhe a janë paguar interesa. Sikurse e thashë, TAP-i ka bërë kërkesa dhe është rimbursuar duke filluar nga mesi i vitit 2017 për 4,5 miliardë lekë. Stoku i kërkesave për rimbursim është 7,4 miliardë lekë dhe këto kërkesa, nisur nga fakti që ne kemi një marrëveshje për shtyrje me 180 ditë nga afti ligjor dhe fakti se administrata tatimore ka lidhur një marrëveshje të posaçme me TAP-in dhe e ka ndarë këtë shumë prej 7,4 milionë në pagesa 300-milionëshe çdo muaj, deri kur të përfundojë, po ta marrësh pastër, ne konsiderohemi që nuk kemi detyrim të pashlyer. Pse? Sepse ky detyrim është rënë dakord të paguhet me këste për TAP-in.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa interesa.

Pra, kjo është situata.

Lidhur me pyetjet e zotit Beqja, “A ka një vlerësim të taksave që janë krijuar dhe paguar si pasojë e aktivitetit të TAP-it?” Natyrisht që ka impakt, sepse 33 miliardë pa TVSH-në, që do të thotë 160 miliardë, do të jetë volumi i materialeve dhe punëve për një periudhë 4-vjeçare. Për periudhën e kaluar, le të themi, është konsumuar 30% e kësaj shume. Natyrisht që ka pasur edhe efekte pozitive.

Ne nuk ishim përgatitur sot të sillnim një pasqyrë të gjerë të efekteve, por ato mund të llogariten, sepse ne kemi 7 nënkontraktorët kryesorë. Ne e dimë se sa TVSH kanë paguar ata, sa kanë paguar më parë dhe mund të bëjmë diferencën. Kemi edhe dhjetëra nënkontraktorë të kontraktorëve të parë. Mund të shohim bilancet e tyre, sa janë rritur në qarkullim dhe në kontribute fiskale, apo sa janë rritur në numër punonjësish, sa kanë pasur dikur dhe sa kanë tani, por konkluzioni nuk mund të jetë i pastër, sepse këto janë kompani, të cilat kontratat me TAP-in i kanë të përfshira në veprimtarinë e tyre. Gener 2 është një kompani që ka një

spektër shumë të gjerë veprimtarish. Shërbimet ndaj TAP-it si nënkontraktor janë një pjesë e vogël e veprimtarisë së saj, apo edhe kompani të tjera si Albastar e të tjerë.

Pra, nuk mund të nxjerrim një konkluzion të saktë në 80,100 apo 120 kompani, se sa ka qenë efekti që ato kanë dhënë vetëm nga një kontratë që kanë pasur, sepse e thashë, kanë pasur edhe volum tjetër punimesh, shërbimesh, apo mallrash.

Pyetja e dytë, “Nënkotaktorët e TAP-it a kanë gjeneruar të ardhura?” E thashë, unë këtu kam një listë të TVSH-së që kanë paguar kontraktorët kryesorë, ashtu sikurse të gjithë nënkotaktorët e tjerë. Pra, ne i matim dhe thjesht duke u nisur nga këto matje bëmë edhe ndryshimin e skemës.

“Autofaturimi ka nevojë të pasqyrohet edhe në ligjet e tjera fiskale.” Autofaturimi, si metodë, është i njohur në ligj. Pra, ju e thatë shumë mirë se nëse merr një furnizim shërbimi nga jashtë, çdo kompani e di dhe e bën skemën e *revers charging*.

Çfarë po zbatojmë në këtë rast? Pra, këtu po përdorim mekanizimin e autofaturimit për të modifikuar skemën e përjashtimit nga TVSH-ja. Kjo është teknika që është përdorur, thjesht për të qenë në rregull me parimet e funksionimit të ligjit të TVSH-së.

Revers charging, si mekanizëm, natyrisht që ka qenë dhe është i parashikuar në ligj dhe përdoret nga çdo kompani që e ka të nevojshme.

Duhet të theksojmë se kjo skemë që po paraqesim ne, që e parashikon edhe direktiva 6 e VAT-it e BE-së, është një skemë që zbatohet për raste të veçanta, pra ne nuk mund ta përdorim rëndom për çdo projekt apo për çdo kompani në Shqipëri. Pra, përdoret për raste të veçanta, kur ka probleme apo kur krijohen probleme madhore, sepse ky stok i parimbursuar, në shifra miliardëshe, krijon probleme madhore, si për shoqërinë, sepse mungojnë paratë, ashtu edhe për shtetin, që duhet të rrezikojë të ardhurat e vitit përkatës.

Prandaj, nuk besoj se do të jenë skema të përhershme, por do të jenë skema për projekte madhore, nëse do të ketë në të ardhmen dhe nëse do të gjykohet e arsyeshme.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I dha përgjigje zoti Stavri, që është specialist i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zoti Marto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Beqaj ka kërkuar fjalën, të lutem!

Ilir Beqaj – Kam edhe dy pyetje të tjera para fjalës.

Me sa kuptova unë, nga shpjegimi që bëtë, kur të fillojë të shërbejë, të operojë, pak a shumë do të bëjë një lloj eksporti shërbimesh, meqenëse ju thatë se nuk do të faturojë për këtu.

Ministria e Infrastrukturës, a ka ndonjë parashikim se sa mund të jetë gjatë operimit normal aktiviteti ekonomik në formën e eksportit të shërbimit?

Eduard Shalsi – Në qoftë se e ka. Nëse nuk e ka, mund ta kalkulojë dhe mund ta referojë në një moment tjetër. Nëse e keni, në rregull. Në qoftë se nuk e keni, mbajeni shënim dhe jepjani...

Ilir Beqaj – Pyetja e dytë. Meqenëse ju e njihni me detaje marrëveshjen, çfarë lehtësirash të tjera fiskale ka marrëveshja, përveç kësaj që ju cituat në nenin 21, për pikën e marrëveshjes?

Ndërkohë, që të mos e marr prapë fjalën më vonë dhe të mos ju bezdis, do u sugjeroja anëtareve të komisionit, t'i kërkojmë qeverisë ta rinegociojë marrëveshjen, duke vendosur si kusht që këto dëmtimet, që ndodhin në infrastrukturë, të riparohen brenda 180 ditëve dhe të mos lihen për në fund të projektit.

Faleminderit!

Nëse komisioni, me shumicë bie dakord, unë abstenoj për marrëveshjen.

Eduard Shalsi – Zoti Sinaj...

Vullnet Sinaj – Unë do të sugjeroja (në vend të mblidhemi për të miratuar kaq shumë marrëveshje, për këto investime që bëhen nga këto firma të huaja) të ndryshojmë ligjin, tek tatimet, tek taksat, tek TVSH-ja, për të gjithë investitorët e huaj, në qoftë se të gjithë e rimbursojnë TVSH-në në këtë mënyrë. S'kemi pse të bëjmë marrëveshje mbas marrëveshjeje.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ka ndonjë koleg tjetër për...?

Zoti Marto, keni ndonjë merak? Nuk keni.

Jeni dakord të kalojmë në votim?

Person m – Po.

(Diskutime pa mikrofon)

Ti kishe një pyetje dhe një sugjerim.

Ilir Beqaj – Kisha dy pyetje dhe pastaj një sugjerim.

Eduard Shalsi – Sugjerimi ishte i treti.

Pyetja e parë do kohë.

Pyetja e dytë. “A ka lehtësira fiskale...?”

Nikolla Lera – Lidhur me pyetjen e parë, duhet të përgatitemi, sikurse e thashë. Natyrisht, me zotin Beqaj komunikojmë dhe mund ta sqarojmë.

“Çfarë lehtësirash të tjera fiskale ka marrëveshja?”. Nuk ka. Pra, do të zbatohet sistemi tatimor që është në fuqi, që do të thotë, nëse fatura për qiranë do t’i bëhet Enel-it në Itali, do të jetë jashtë objektit të TVSH-së, ndërsa nëse faturimi i gazit do t’i bëhet operatorit të shpërndarjes së gazit në Shqipëri, që mund të krijohet, natyrisht që do të jetë shitje malli dhe faturat do të jenë me TVSH, sipas ligjit shqiptar.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Bëri një sugjerim zoti Beqaj dhe një sugjerim zoti Sinaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thashë pra, e thashë.

...në lidhje me krijimin e një norme ligjore për të gjithë investitorët, që janë të pranishëm në Shqipëri, mbi një kufi të caktuar investimi, pra të mos jetë individuale, por të jetë përcaktuar një normë ligjore, që të përfshijë një shifër investimi, le të themi, x apo...

Nikolla Lera – Mundem, të lutem?

Eduard Shalsi – Po.

Nikolla Lera – Në legjislacion e kemi një parim të tillë. Ne kemi thënë se kushdo që do të investojë mbi 50 milionë lekë, gjithë importin e makinerive dhe të pajisjeve e ka të përjashtuar nga TVSH-ja, pra ky është ai inventivi që është dhënë për të gjithë.

Projekte madhore të natyrës së TAP-it, që ka 34 miliardë TVSH apo të Devollit, që kishte 20 miliardë TVSH, nuk besoj se do të jenë të shpeshta në Shqipëri, që të kalojmë në skema të tilla.

Eduard Shalsi – Qartë.

Faleminderit!

Atëherë, kalojmë direkt në votim.

Po...

Eglantina Gjermeni - Sa është shuma e investimit...?

Nikolla Lera – 33 miliardë TVSH herë 5, 160 miliardë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Shqipëri.

(Diskutime pa mikrofon)

Për sugjerimet e zotit Beqaj? I pari kishte të bënte me diçka që del përtej pozicionit tuaj, që do ta shqyrtojmë.

I dyti...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nikolla Lera – Ndryshimin e marrëveshjes për dëmet, zoti Stavri.

Stavri Dhima – Ne kemi detyrimin, si Ministri Infrastrukture, të ndjekim realizmin e projektit TAP. Në marrëveshjen që është ndryshuar (e para u miratua në vitin 2013 dhe u ndryshua në vitin 2017) është parashikuar që këto detyrime që ka TAP-i, të plotësohen brenda kohës. Madje, për këtë qëllim....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Stavri Dhima– Rrugët të jenë të aksesueshme, të përdorshme normalisht, gjatë gjithë kohës, jo brenda 18 muajve. Të jenë të aksesueshme vazhdimisht, në mënyrë permanente.

Ilir Beqaj – Mbylle pak mikrofonin, se nuk dua ta ndez unë.

I bie që unë si ministri nuk bëj punë.

Ju thatë deri në fund... E di unë, nuk ikën pa e mbaruar ai, se ka edhe respekt ndaj vetes, por ne t'i kërkojmë përditshmërinë. Në qoftë se ka një marrëveshje, atëherë nuk e bëkeni ju.

Prandaj duhet përfaqësi politike, zoti Shalsi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – U bë një pyetje. Në rastin konkret, përgjigja e duhur do të kishte qenë: “Duhet ta shohim kur është ndërtuar...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo që kam shprehur, zoti Beqaj, është që kam kërkuar për TAP-in një sistem monitorimi dëmsh në një *real time*. Pra, ka një dëmtim...

Ilir Beqaj – Ta rikthejmë për negociim marrëveshjen, atëherë.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Faleminderit, kolegë deputetë, për pyetjet, sugjerimet dhe vërejtjet.

Nga ana tjetër, e mbajta shënim vërejtjen tuaj për prezantimin në nivel politik. Gjithsesi, jam shumë i kënaqur, sepse nga eksperiencia e gjithë këtyre viteve, shpeshherë niveli i lartë politik nuk u ka dhënë përgjigje pyetjeve tuaja të detajuara, shumë teknike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë në votim.

Kush është dakord në parim?

Ka kundër? Abstenim? Ka një abstenim.

Miratohet.

Neni 1 .

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka

Në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim. 1 abstenim.

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA